

# Mbrojtja e Liqenit të Ohrit

“DREJT NJË QEVERISJEJE TE PËRBASHKËT TË TRASHËGIMISË NATYRORE DHE KULTURORE NDËRKUFITARE TË RAJONIT TË LIQENIT TË OHRIT”

## NË KËTË NUMËR

- 1** Parathënie nga Lydia Topuzovska, Sekretare e përgjithshme e Komisionit Kombëtar të UNESCO në Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë (faqe1)
- 2** #OurLakeOhrid - Konkurs fotografie në Mediat Sociale (faqe 2)
- 3** Takimet e Projektit (faqe 3)
- 4** Intervistë me Zhulieta Harasani nga Ministria e Kulturës e Republikës së Shqipërisë (faqe 4)
- 5** Këshilli Kombëtar Shqiptar i Restaurimeve përcakton kufijtë për zgjerimin potencial të pasurisë së Trashëgimisë Botërore (faqe 4)
- 6** Rezultatet e pyetësorit të Rajonit të Liqenit të Ohrit (faqe4)
- Turizmi**
- 7** Struga- Qyteti i Poezisë (faqe5)
- 8** Gratë e Tushemishtit (faqe 5)
- Aktivitete**
- 9** Dita e Liqenit të Ohrit (faqe 6)
- 10** Festivali i filmit mjedisor, Shqipëri (faqe 6)
- 11** Aktivitetet e ardhshme? Partnerët e Projektit (faqe7)

“ Ky vend unik, i krijuar nga njerëzit dhe natyra, meriton të mbrohet si i tërë dhe për këtë, pa dyshim koha ka ardhur.. ”

Të dashur lexues!

Rajoni i Liqenit të Ohrit ka një trashëgimi unike kulturore dhe natyrore me vlerë të jashtëzakonshme universale, duke bërë të mundur futjen e pjesës maqedonëse në listën e Trashëgimisë Botërore në UNESCO në vitet 1979-1980. Maqedonasit janë në përpjekje të vazhdueshme për të mbrojtur dhe ruajtur këtë trashëgimi. Në këtë drejtim, janë miratuar disa ligje dhe rregulla në nivel kombëtar, të cilat rregullojnë mënyrat, kushtet dhe mundësitë për mbrojtjen e trashëgimisë natyrore dhe kulturore të rajonit. Të kesh statusin ‘Trashëgimi Botërore’ është një privilegj i madh, por ky status vendos detyra dhe përgjegjësi për të gjithë shoqërinë. Ai kërkon që të zbatohet në mënyrë të vazhdueshme standardet ndërkombëtare në ruajtjen dhe mbrojtjen e vlerave të njohura nëpër botë.

Që në fillim të projektit “Drejt një qeverisjeje të përbashkët të trashëgimisë natyrore dhe kulturore ndërkufitare të rajonit të Liqenit të Ohrit”, Ministria Maqedonase e Kulturës, Zyra e Mbrojtjes së Trashëgimisë Natyrore dhe Kulturore si dhe Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, kanë qenë të përfshirë nëpërmjet përfaqësuesve të tyre në mënyrë aktive në të gjitha aktivitetet e projektit, duke dhënë mbështetjen maksimale për realizimin dhe zbatimin e projektit që do zbatohet në të ardhmen. Ruajtja e Liqenit të Ohrit, një vend thesar për speciet endemike të florës dhe faunës dhe një nga ekosistemet më të mira në botë, është një objektivi i përbashkët me fqinjin tonë, Republikën e Shqipërisë. Ne besojmë se me përpjekje të përbashkëta do të arrijmë një zbatim të suksesshëm të këtij procesi, duke rezultuar në një menaxhim efektiv dhe efikas të integruar të rajonit të Liqenit të Ohrit.

Të vetëdijshëm për domosdoshmërinë e këtij procesi dhe duke minimizuar sfidat që ndikojnë negativisht në trashëgiminë kulturore dhe natyrore të rajonit si: çështjet e urbanizimit të gjerë dhe të pakontrolluar, trajtimin e ujërave të zeza, mbishfrytëzimin dhe shkatërrimin e vlerave natyrore dhe mungesën e njohjeve të vlerave të këtij rajoni, ne mirëpresim kontributin e UNESCO-s dhe organeve këshilluese të Komisionit të Trashëgimisë Botërore ICCROM, ICOMOS dhe IUCN, të cilat me anë të angazhimit të tyre në këtë proces të na mundësojnë si të identifikojmë më mirë dhe të adresojmë këto sfida.

Duke pasur parasysh rëndësinë e jashtëzakonshme të rajonit të Liqenit të Ohrit, Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë, përmes institucioneve të saj kombëtare do të vazhdojë me altruizëm të kujdeset për mirëqenien e tij, një përgjegjësi që i përket jo vetëm institucioneve por edhe çdo individ. Ky vend unik, i krijuar nga njerëzit dhe natyra, meriton të mbrohet si i tërë dhe, pa dyshim, koha ka ardhur. Ky proces është vetëm fillimi asaj që do të pasojë; menaxhimi i përbashkët dhe krijimi e një sistemi të integruar për menaxhimin e trashëgimisë së vlerave kulturore dhe natyrore të rajonit të liqenit të Ohrit për veten tonë, dhe për brezat që do të vijnë.

Sinqerisht e Juaja,

*Lydia Topuzovska*

Sekretare e Përgjithshme e Komisionit Kombëtar të UNESCO-s në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë



# Fituesit e konkursit të fotove #OurLakeOhrid

Liçeni i Ohrit ka një bukuri të veçantë. Është liçeni më i thellë dhe më i vjetër në Europë me një ekosistem unik dhe shtëpia e shumë specieve endemike. Gjithë rajoni ka një trashëgimi të pasur kulturore, për të cilën shumë njerëz që jetojnë rreth tij duhet të jenë në vetëdijshëm.

Për të theksuar bukurinë dhe vlerat si dhe për të rritur ndërgjegjësimin e komunitetit, duke i ftuar ata të ndajnë kujtimet, mendimet dhe historitë rreth Liçenit, një konkurs fotografie u organizua në kuadrin e Projektit “Drejt një qeverisje të përbashkët të trashëgimisë natyrore dhe kulturore ndërkufitare të rajonit të Liçenit

të Ohrit”, të financuar nga BE dhe Qeveria Shqiptare

Konkursi i fotografisë #OurLakeOhrid u zhvillua në Instagram dhe faqen e Facebook -ut të projektit. Konkursi u hap në 7 mars dhe përfundoi më 7 prill 2016. Më shumë se 450 foto u postuan nga pjesëmarrësit.

Në fund të garës, rreth 50 foto u përzgjedhën nga stafi i UNESCO-s dhe Bordeve këshillimore: ICCROM, ICOMOS and IUCN. Më pas partnerët nga Qeveria Shqiptare, Institucionet Shqiptare dhe Bashkimi Europian, si dhe partnerët e tjerë rajonalë përzgjedhën 10 fotot më të mira, bazuar

në kriteret e shpallura më parë të këtij konkursi. Përmes njerëzve, dritave dhe ngjyrave, vendeve, formave dhe historive të kapura në këto foto, ne mundëm të shihnim vlerat unike të trashëgimisë natyrore dhe kulturore të Liçenit të Ohrit. Një trashëgimi që kemi nevojë më shumë se kurrë ta mbrojmë, dhe t’ua lëmë brezave të ardhshëm. Dhjetë fituesit e këtij konkursi janë: Adnan Adnan Beci, My Best Souvenir - Teodora Krasimirova Koleva, Betim Berisha, Ardian Fezollari, Elena Nikolovska, Slavica Panova, Marijana Pipe Pipileva, Stefanija Vidovski, Nikola Naumoski dhe Marko Blazevski.



Ardian Fezollari



Slavica Panova



Marko Blazevski




Betim Berisha



Adnan Beci



Teodora Krasimirova Koleva



Elena Nikolovska



Marijana Pipe Pipileva



Stefanija Vidovski



Nikola Naumoski

TOP 10



Ceremonia e çmimeve në Pallatin e Kulturës, Pogradec

## Ceremonia e shpalljes së çmimeve

Një ceremoni e posaçme për shpalljen e 10 fituesve të këtij konkursi, u organizua në Pallatin e Kulturës Pogradec, më 10 maj 2016. Konkursi i fotografisë tërhoqi një numër të madh pjesëmarrësish kryesisht nga Shqipëria, Maqedonia dhe Bullgaria si dhe vizitorë të huaj të Liçenit të Ohrit, të cilët ndanë emocionet e tyre, kujtimet dhe historitë. Tre nga fituesit ishin të pranishëm në këtë ceremoni në Pogradec, të cilët u nderuan zyrtarisht me dorëzimin e çmimit përkatës. Fituesve iu shpërndanë certifikata dhe një çantë me produkte me logon e Rajonit të Liçenit të Ohrit. Gjatë ceremonisë, një nga fituesit nga Pogradeci, z. Fezollari u shpreh: “Nuk jam këtu që të flas si fotograf, por si qytetar. Ne nuk garuam për çmimin, por e konsideruam si një mundësi për të kontribuar disi për Liçenin tonë të Ohrit. Ne i detyrohemi kaq liçenit tonë”. Numri i madh i pjesëmarrësve në këtë konkurs, tregoi dhe njëherë interesin e lartë nga komunitetet lokale dhe nga turistët për vlerat dhe bukurinë e Liçenit të Ohrit. Një tjetër konkurs do të zhvillohet në një fazë më të vonë, dhe paneli i votuesve do jenë pikërisht këtë 10 fitues të konkursit të parë.

# Takimet e Projektit



## Takimi i Tretë i platformës ndërkuftare për ruajtjen e rajonit të Liqenit të Ohrit

Takimi i Tretë Ndërkuftar i projektit “Drejt një qeverisjeje të përbashkët të trashëgimisë natyrore dhe kulturore ndërkuftare të rajonit të Liqenit të Ohrit”, u zhvillua më 7 mars 2016 në qytetin e Pogradecit. Përfaqësues nga Ministria e Kulturës dhe Ministria e Mjedisit, nga Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, përfaqësues të qeverive lokale përreth liqenit, përfaqësues të organeve këshilluese (ICOMOS dhe IUCN), si dhe UNESCO-s, diskutuan për një platformë të qëndrueshme bashkëpunimi. Në këtë takim u diskutua në mënyrë specifike mbi mundësitë e proceseve ekzistuese ndërkuftare për monitorimin e mjedisit dhe biodiversitetit, të cilat kontribuojnë në ruajtjen dhe menaxhimin e rajonit të Liqenit të Ohrit. Përveç mbështetjes së vazhdueshme lokale, dypalëshe dhe shumëpalëshe për infrastrukturën e shumta, trajnimeve, edukimit, ndërtimit të vetëdijes, marketingut dhe promovimit të iniciativave në rajonin e Liqenit të Ohrit, kontributi më i rëndësishëm i këtij projekti synohet të jetë bashkërendimi i gjithë kësaj pune nën ombrellën e një strategjie dhe strukture të përbashkët menaxhimi për Liqenin e Ohrit.

## Trajnimi për menaxhimin dhe bashkëpunimin e integruar për mbrojtjen e trashëgimisë së peisazheve

Trajnimi për menaxhimin dhe bashkëpunimin e integruar për mbrojtjen e trashëgimisë së peisazheve, një kurs dy-ditor, pjesë e projektit “Drejt një qeverisjeje të përbashkët të trashëgimisë natyrore dhe kulturore ndërkuftare të rajonit të Liqenit të Ohrit”, u zhvillua në 31 Mars - 1 Prill 2016 në Gadishullin e Linit, Pogradec. Ky kurs i shkurtër mbledhi përfaqësues të të gjithave palëve të interesuara për të kuptuar se si mund të zhvillojnë një qasje të integruar dhe bashkëpunuese për menaxhimin e peisazheve në përgjithësi. Kursi u



përqendrua në të mësuarit në mënyrë interaktive, ku theksi ishte puna në grup, ushtrimet praktike, rastet studimore dhe puna në terren.

Menaxhimi pjesës së zgjeruar të pasurisë së Trashëgimisë Botërore “ Natyrore dhe Kulturore të rajonit të Liqenit të Ohrit” në Shqipëri dhe pjesët e peisazheve të mbrojtura të Pogradecit kërkon një qasje

## Promovimi i natyrës, kulturës dhe trashëgimisë Botërore në rajonin e Liqenit të Ohrit



Pjesëmarrësit e trajnimit duke vizituar kalane e Pogradecit

përparimin e procesit të planifikimit të menaxhimit, në funksion të zgjerimit të pjesës shqiptare të pasurisë së Trashëgimisë Botërore të rajonit të Liqenit të Ohrit, me ide që do të adresojnë nevojën për ndërtuar histori unike rreth një identiteti të përbashkët për këtë trashëgimi të përzier ( natyrore dhe kulturore) ndërkuftare.

Në përputhje me strategjinë e ndërtimit të kapaciteteve të trashëgimisë Botërore 2011, trajnimi synon përkrahje ndërtimit e kapaciteteve të ruajtjes së trashëgimisë për praktikantët, institucionet, organizatat, komunitetet për menaxhimin e trashëgimisë dhe konservimin e rajonit të Liqenit të Ohrit nga vetë aktorët lokalë.

Trajnimi ofroi raste studimore botërore dhe ushtrime në grup dedikuar të gjithë rajonit të Liqenit të Ohrit. Pjesëmarrësit ishin në gjendje të kuptonin rolin e trashëgimisë botërore në zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm, zhvillimin e audiencës, mbledhjen e të dhënave dhe planifikimin strategjik. Kursi përfshinte një ushtrim se si duhet të reklamohet i gjithë rajoni i Liqenit të Ohrit dhe vlerat e tij.

bashkëpunuese, që përfshin një numër të madh të palëve të interesuara për këto zona. Është e nevojshme të krijohet një ekuilibër harmonie mes natyrës, kulturës, peisazhit dhe zhvillimit. Këto janë detyrat që duhet të përgatisin përfaqësuesit e strukturave të pushtetit vendor dhe qendror për zbatimin e këtij projekti.

## Seminari i katërt dhe i pestë i planifikimit për menaxhimin e rajonit të Liqenit të Ohrit

Seminari i katërt i planifikimit për menaxhimin e rajonit të Liqenit të Ohrit u zhvillua më 12-13 Maj, në Tushemisht, Pogradec. Ky seminar u zhvillua në kuadër të serisë së takimeve të projektit “Drejt një qeverisjeje të përbashkët të trashëgimisë natyrore dhe kulturore ndërkuftare të rajonit të Liqenit të Ohrit”, financuar nga Bashkimi Evropian dhe Ministria e Mjedisit e Shqipërisë. Seminari prezantoi ecurinë e deritanishme të dokumentit të planifikimit të menaxhimit, i nevojshëm për dosjen e zgjerimit të Trashëgimisë Botërore të rajonit të Liqenit të Ohrit” (ish Republika Jugosllave e Maqedonisë) me pjesën shqiptare të liqenit të Ohrit. Nëpërmjet punës së madhe në grup, seminari kishte në fokus: a) përgatitjen e një plani të përgjithshëm (Master Plan) për Bashkinë e Pogradecit, b) Gadishullin Lin, c) Drilonin, d) Memlishtin dhe rrethinat e tij, dh) ambientet ekologjike dhe natyrore të rajonit të Liqenit të Ohrit. Gjithashtu u diskutuan veprimet prioritare që duhet të kryhen në afat të shkurtër dhe të mesëm nga autoritetet përkatëse.

Kursi i trajnimit “Promovimi i natyrës, kulturës dhe trashëgimisë Botërore në rajonin e Liqenit të Ohrit”, u zhvillua në Pogradec dhe Tushemisht, Shqipëri, më 10 dhe 11 maj 2016. Trajnimi u mundësoi pjesëmarrësve marrjen e njohurive të domosdoshme për promovimin dhe interpretimin e të gjitha aseteve të rëndësishme natyrore dhe kulturore për njerëzit, duke evidentuar vlerat e përbashkëta të trashëgimisë tek audiencia ekzistuese dhe tek audiencat e ardhshme, në mënyrë që të arrihen objektivat e përbashkëta për menaxhimin e trashëgimisë.

Trajnimi ka kontribuar në mënyrë indirekte në

ndërtimin e procesit të planifikimit të menaxhimit, në funksion të zgjerimit të pjesës shqiptare të pasurisë së Trashëgimisë Botërore të rajonit të Liqenit të Ohrit, me ide që do të adresojnë nevojën për ndërtuar histori unike rreth një identiteti të përbashkët për këtë trashëgimi të përzier ( natyrore dhe kulturore) ndërkuftare.

Në përputhje me strategjinë e ndërtimit të kapaciteteve të trashëgimisë Botërore 2011, trajnimi synon përkrahje ndërtimit e kapaciteteve të ruajtjes së trashëgimisë për praktikantët, institucionet, organizatat, komunitetet për menaxhimin e trashëgimisë dhe konservimin e rajonit të Liqenit të Ohrit nga vetë aktorët lokalë.

Trajnimi ofroi raste studimore botërore dhe ushtrime në grup dedikuar të gjithë rajonit të Liqenit të Ohrit. Pjesëmarrësit ishin në gjendje të kuptonin rolin e trashëgimisë botërore në zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm, zhvillimin e audiencës, mbledhjen e të dhënave dhe planifikimin strategjik. Kursi përfshinte një ushtrim se si duhet të reklamohet i gjithë rajoni i Liqenit të Ohrit dhe vlerat e tij.



Seminari i pestë dhe i fundit i planifikimit të menaxhimit të rajonit të Liqenit të Ohrit, u zhvillua më 22-23 qershor 2016, në Udënisht, në zonën e Pogradecit.

Seminari u përqendrua në konceptin e qeverisjes, në kërkesat e Komisionit të Trashëgimisë Botërore për sistemin e menaxhimit dhe tek Komiteti i Menaxhimit të Zonave të Mbrojtura në Shqipëri. Përveç kësaj, seminari identifikoi temat priorare për objektivat dhe veprimet që duhen ndërmarrë për zhvillimin e qëndrueshëm të rajonit të Liqenit të Ohrit në Shqipëri. Rezultatet e punës në grup dhe konkluzionet e diskutimeve të panelit të kontribuan në hartimin e dokumentit të planifikimit të menaxhimit të kërkuar, si pjesë e dosjes për pasurinë e Trashëgimisë Botërore; dokumenti i planifikimit të menaxhimit do të përpunohet nga “Grupi i ekspertëve” në vjeshtë të vitit 2016 dhe do të prezantohet për konsultim publik në fund të vitit 2016. Angazhimi dhe prurjet profesionale nga autoritetet e ndryshme Shqiptare dhe nga ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë kanë qenë vendimtare për suksesin e këtij procesi për planifikimin e menaxhimit.

# INTERVISTË ME ZHULIETA HARASANIN

Drejtoreshë e përgjithshme e planifikimit strategjik të Trashëgimisë kulturore dhe diversitetit, Ministria e Kulturës e Shqipërisë



## Znj. Harasani, si po ecën projekti “Drejt një qeverisjeje të përbashkët të trashëgimisë natyrore dhe kulturore ndërkufitare të rajonit të Liqenit të Ohrit”?

Projekti ndërkufitar për bashkërendimin e menaxhimit të Liqenit të Ohrit, tashmë ka hyrë në fazën finale të tij. Megjithatë institucioni lider për palën shqiptare në këtë projekt është Ministria e Mjedisit, Ministria e Kulturës përmes Drejtorisë së Përgjithshme të Trashëgimisë dhe Diversitetit Kulturor dhe institucioneve të saj të varësisë si Instituti i Monumenteve të Kulturës dhe Drejtorisë Rajonale të Kulturës Kombëtare Korçë ka qenë dhe mbetet plotësisht e angazhuar dhe e përfshirë në përgatitjen dhe ndjekjen me rigorozitet të rekomandimeve të dala nga takimet e organizuara në këtë kuadër, për të plotësuar në kohë dosjen për zgjerimin e Trashëgimisë botërore të rajonit të Liqenit të Ohrit me pjesën shqiptare të Liqenit të Ohrit.

## Cilat janë angazhimet e Ministrisë së Kulturës lidhur me pjesën e trashëgimisë kulturore?

Në zbatim të rekomandimeve të ekspertëve të ICOMOS, IUCN dhe ICCROM, ekspertët tanë po punojnë për të siguruar mbrojtjen dhe integritetin e Vlerave të trashëgimisë kulturore të zonës së mundshme të rajonit të Liqenit të Ohrit që do të përfshihet në Listën e trashëgimisë botërore të UNESCO-s. Me një vendim të Ministres së Kulturës në Mars 2016 është shpallur zona e mbrojtur e monumentit të kulturës kategoria I-rë “Rrënojat kishës paleokristiane dhe mozaikët” në fshatin Lin, Pogradec. Në zbatim të Ligjit për trashëgiminë kulturore, në zonën e mbrojtur ndalohet çdo ndërhyrje me karakter ndërtimor. Po kështu, në vijim të misionit në terren (field mission) të datave 29 - 30 mars 2016 nga grupi ndër-institucional me përfaqësues të ICOMOS, IUCN, IMK, AKZM, ARZM, Instituti Arkeologjik dhe Bashkia Pogradec, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve ka miratuar me 25.05.2016: Propozimin e kufirit të zonës së mundshme për shpallje pasuri botërore e UNESCO-s, vendim i cili i është përcjellë Qendrës së Trashëgimisë të Botërore të UNESCO-s dhe Ministrisë së Mjedisit, institucioni shqiptar lider në projekt. Gjithashtu, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Ministria e Kulturës ka ndërmarrë nismën për ratifikimin e Konventës Europiane të Peisazhit e cila përcakton qartë kërkesat dhe kriteret për ruajtjen dhe promovimin e peisazheve në përgjithësi dhe atyre kulturore dhe natyrore në veçanti. Besoj se kjo Konventë do të jetë një tjetër “instrument” në duart e menaxherëve të kësaj pasurie botërore.



të Trashëgimisë Botërore. Nga ky pyetësor u mblodhën një sërë të dhënash nëpërmjet intervistimit të njerëzve që jetojnë, punojnë ose vizitojnë zonën. Pyetësori u zhvillua nga Z. Genci Angjellari, i kontraktuar nga IUCN në bashkëpunim me Manderina Promotions në një fushatë intensive pesë-ditore. Nga 116 njerëz, 78 vendas dhe 38 vizitor, u intervistuan në zona të ndryshme përgjatë pjesës shqiptare të liqenit të Ohrit, duke përfshirë edhe qytetin e Pogradecit dhe fshatrat: Lin, Tushemisht, Udënisht, Vërdovë, Starovë dhe Drilon. Pyetësori fillonte me pyetjet mbi vlerat dhe atributet e rajonit të liqenit të Ohrit, që të kuptoheshin marrëdhëniet dhe lidhjet ekzistuese të publikut me trashëgiminë e tyre dhe në mënyrë indirekte, nivelin e kënaqësisë me situatën e deritanishme. Pjesët pasard-

## ARRITJE E PROJEKTI

### Këshilli kombëtar shqiptar i restaurimit miraton kufijtë e zonës së mundshme për Pasuri Botërore të Uneskos

Këshilli kombëtar i Restaurimeve në varësi të Ministrisë së Kulturës, përmes një vendimi të datës 25 maj 2016 ka miratuar propozimin për përcaktimin e kufijve të zgjerimit të mundshëm të pasurisë ndërkufitare të Trashëgimisë Botërore të Liqenit të Ohrit dhe zonës së saj. Bazuar në rezultatet e misionit faktëmbledhës të kryer nga ICOMOS, IUCN, ICM, AKZM, RAPA, Bashkia e Pogradecit dhe Instituti i Arkeologjisë kryer në mars të vitit 2016, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve vendosi të miratojë propozimin e kufirit që do të përfshijë: vijën e Bregut të Liqenit, veçoritë Kulturore të pejsazhit të Gadishullit të Linit dhe Fshatit Lin, Zonat kritike për integritetin skenik të Liqenit (Driloni, peisazhi i bregut në veri të Linit) si dhe zonat ku janë identifikuar vendbanimet palafite.

Ky është një hap i madh për përgatitjen e dosjes nominale për të zgjeruar pasurinë e Trashëgimisë Botërore të Rajonit të Liqenit të Ohrit me pjesën shqiptare.

### A është gati Shqipëria për të menaxhuar dhe ruajtur një trashëgimi të tillë në bashkëpunim me palën maqedonase?

Shqipëria ka një eksperiencë më tepër se 20 vjeçare në menaxhimin e vlerave të jashtëzakonshme universale (outstanding universal value - OUV). Ministria e Kulturës në këto dy vite ka dëshmuar angazhimin maksimal të saj për përbushjen dhe ndjekjen me rigorozitet të detyrimeve të anëtarësimit në Konventën e Trashëgimisë Botërore Natyrore dhe Kulturore dhe rekomandimeve të ICOMOS. Ndërsa ka përmirësime të punës dhe rezultateve, ka ende shumë për të bërë. Kjo mbetet sfida jonë ndërkohë që kësaj sfide i shtohet edhe detyrimi për t'u bashkërenduar institucionalisht jo vetëm së brendshmi, me institucionet e specializuara përgjegjëse qendrore dhe vendore, por edhe me simotrat në vendin fqinj Maqedoni. Ashtu si dhe për parnerët tanë maqedonas, sfida e ruajtjes dhe mbrojtjes së vlerave të trashëgimisë kulturore në një kontekst bashkëkohor vazhdimisht në presionin e zhvillimeve urbane, ka qenë dhe mbetet një angazhim konstant. Institucionet përgjegjëse (jo vetëm ata të trashëgimisë kulturore) të të dy vendeve kanë filluar tashmë ta trajtojnë rajonin e liqenit të Ohrit si një hapësirë të përbashkët që nuk ka vetëm vlerë e përfitime, por dhe përgjegjësi e detyrime.

### Kur do të jetë gati dosja për futjen në UNESCO të pjesës shqiptare të Liqenit të Ohrit?

Mendojmë dhe besojmë se dosja ndërkufitare e kandidimit do të finalizohet brenda muajit janar 2017 për t'u dorëzuar zyrtarisht në UNESCO brenda muajit mars 2017. Ndonëse po punohet me grupe ekspertësh të institucioneve më në zë kombëtare dhe ndërkombëtare në fushën e mjedisit dhe të trashëgimisë kulturore falë mbështetjes së pakursyer të EU dhe UNESCO, kjo është një sipërmarrje dhe angazhim madhor për të dy shtetet palë në këtë Konventë të Trashëgimisë Botërore të UNESCO-s, që nuk përfundon me finalizimin e dosjes së kandidimit.

## Pyetësor për Liqenin e Ohrit

### Çfarë i vjen në mendje gjithkujt kur përmend Liqenin e Ohrit? Korani, bregu i liqenit, varkat, noti, natyra? Ndoshta të gjitha!

Në kuadër të projektit, u zhvillua një pyetësor në pjesën shqiptare të rajonit të liqenit të Ohrit për të mësuar pikëpamjet e njerëzve të rajonit. Pyetësori u ideua nga ICCROM, organi këshillues i Komisionit

hëse të pyetësorit u adresoheshin turizmit dhe eksperiencës së vizitorëve, në mënyrë që të kuptohej ndikimi i turizmit në vlerat e paprekshme dhe jetesës tradicionale në rajonin e liqenit të Ohrit.

Rezultatet e para treguan se popullsia lokale ka lëvizur kryesisht në zonat e liqenit dhe ka shijuar pasuritë e tij. 10 % e banorëve përfitojnë në një mënyrë apo në një tjetër nga bizneset dhe mundësitë e punësimit që lidhen me turizmin. Vizitorët në rajonin e liqenit të Ohrit duket se janë vendas dhe së bashku me banorët lokalë ata kanë identifikuar një sërë përvojash pozitive në lidhje me peisazhin kulturor dhe natyror. Rezultatet e kësaj fushate modeste demonstronjë rëndësinë e konsultimit me publikun për zgjerimin e pasurisë botërore të liqenit të Ohrit me pjesën shqiptare si dhe për të informuar me këto rezultate organet vendimarrëse për menaxhimin e trashëgimisë së rajonit të liqenit të Ohrit dhe promovuar atë si një destinacion turistik.



## Struga-Qyteti i Poezisë

Struga është një qytet në jug-perëndim të ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë. Ajo shtrihet në brigjet e liqenit të Ohrit në burimin e lumit Drini. Struga është qytet i qetë. Shtëpitë janë të bukura dhe të zbukuruar. Një thënie e njohur që thotë: “Nuk ka asnjë vend tjetër si Struga”, përdoret edhe në ditët e sotme. Drini i Zi rrjedh ngadalë nëpër qytet, pasi nuk dëshiron të bezdisë vizitorët që ecin përgjatë brigjeve të tij. Ka plot vende të tjera që tregojnë bukurinë dhe kulturën e qytetit të Strugës, si pazari i vjetër, kishat dhe xhamitë e vjetra.

“Mbremjet e poezisë” në Strugë konsiderohet një ngjarje shumë e rëndësishme në qytet. Ky event zhvillohet përvit në gjysmën e dytë të gushtit për më shumë se 40 vjet. Kjo ngjarje mbledh poetë, shkrimtarë dhe artistë nga e gjithë bota. Dy janë çmimet që jepen: një për arritje jetësore dhe një për poetët e rinj.

### Çfarë të shihni?

Struga e sotme është mjaft moderne. Dikush mund të shijojë një shëtitje të këndshme nëpër qytet përgjatë lumit dhe bregut të liqenit. Një destinacion kryesor është Pazari i Vjetër, një treg gjallërues i rrethuar me shtëpi tradicionale, kafene dhe dyqane. Aty pranë kryqëzimit ndodhet dhe Kisha e Shën Gjergjit, e



Mbremjet e poezisë ne Struge

ndërtuar në vitin 1835 mbi themelet e një objekti të vjetër të shenjtë, një model i shkëlqyer i periudhës së rigjallërimit të arkitekturës. Ikonostasi është unik, pjesa e poshtme është prej guri, ndërsa pjesa e sipërme është prej druri me detaje të gdhendura.

Halveti Teke, ndërtesa fetare është ndërtuar nga Hasan Baba (Asan Dede) në fillim të shekullit të 18-të, një model klasik i arkitekturës osmane, e mbrojtur nga Instituti Memorial Kulturor i Maqedonisë, ndërsa modele të tjera të arkitektures Osmane interesante mund të shihen nëpër rrugët e Vëllezërve Milladinov dhe Niko Nestor në afërsi të pazarit.

Në afërsi të lumit ndodhet stutaja “Vajza që shkon të mbush ujë”, statujë e cila simbolizon traditën e vajzave të reja dhe nuseve që marrin ujë nga burimi për t’i çuar në shtëpitë e tyre.

Muzeu Natyror Kombëtar i Strugës përmban më shumë se 10.000 ekzemplarë të florës dhe faunës të rajonit të liqenit të Ohrit dhe rajonit liqenit të Prespës. Ndërkohë, Muzeu i Strugës prezanton 150 artikuj të veshjeve popullore nga i gjithë vendi, duke përfshirë kostume të plota, bizhuteri dhe 80 objekte të tjera shtëpiake, si edhe një koleksion të madh fotografish. Kisha e Shën Dhimitrit është një kishë e vogël kushtuar Shën Dhimitrit, në pjesën perëndimore të qytetit.

### Çfarë të bëni?

Ju mund të shijoni një udhëtim një-ditor me varkë në Ohër, duke e kombinuar me një vizitë në fshatrat përgjatë bregut perëndimor të liqenit të Ohrit, ku një veçori kryesore, përveç plazheve të bukura e të qeta, janë kishat-shpellë. Struga është një qytet i sheshtë, i shtrirë nëpër lumin Drin dhe është një vend fantastik për t’u relaksuar duke pirë një filaxhan kafe. Është qytet i vogël dhe mund të përshkohet në këmbë. Duhet vetëm 15 minuta ecje përgjatë liqenit dhe mund të mbërrini në fshatin Kalisht dhe në Manastirin-shpellë. Për ata që duan më shumë aventura dhe aktivitete në natyrë, ngjitje, çiklizëm, nuk ka limite në pyllin e malit të Vodnos. Para perëndimit të diellit mund të shijoni tri lloje të ndryshme plazhesh: “maška plaza”, “Ženska plaza”, “Gull Beach” që ndodhen pranë burimit të Drinit të Zi. Black Drin.

## Gratë e Tushemishtit



Tushemisht, “Skulptura e Zonjës nga Qyteti”

*“Një kombinim përfekt i mikpritjes dhe privacisë totale për miqtë. Jashtëzakonisht pastër. Në këtë fshat të qetë ju mund të dëgjoni vetëm ujën e burimit që rrjedh nëpër kanale përgjatë rrugëve gjatë natës. Mëngjesi më i mirë që kam ngjënë prej vitesh-i thjeshtë por vertet një produkt i veçantë lokal.”*

Jane Thompson, ICCROM

Tushemishti është një fshat i vogël afër Pogradecit në Shqipëri. Ndodhet në Brigjet e Liqenit të Ohrit në kufirin mes Shqipërisë dhe Maqedonisë. Fshati u bë i famshëm në Shqipëri pas shfaqjes për herë të parë të filmit komedi “Zonja nga Qyteti”, në të cilin një nga aktoret më të njohura dhe më të dashura shqiptare, Violeta Manushi luan rolin e Teto Ollgës. Historia flet për lidhjet mes fshatit dhe një zonje të moshuar nga qyteti, e cila u zhvendos për të jetuar në fshat së bashku me vajzën e saj të bukur. Në kohën e komunizmit, të rinjtë e sapodiplomuar dërgoheshin në fshat për të punuar, për të fituar përvojë dhe për të kontribuar në terren. Vajza e saj Meli ishte infermiere. Teto Ollga fillimisht kishte një ndjenjë superioriteti ndaj banorëve të fshatit, por në fund ajo e gjen veten mes tyre duke punuar si kuzhinierë

dhe duke kontribuar për komunitetin. Përveç se është një histori humor, filmi shfaq dhe panoramën e bukur të fshatit, kanalet e shumtë, liqenin, parkun e Drilonit dhe malet e lartë.

Tushemishti ka patur një traditë të hershme në mikëpritjen e të huajve në shtëpitë e tyre. Familjet nga gjithë Shqipëria prej kohësh kanë ardhur në këtë zonë për të kaluar pushimet, dhe mikpritjen pikërisht në shtëpitë e banorëve të zonës. Njerëzit janë shumë miqësorë, të qetë dhe kanë një buzëqeshje të çiltër. Shtëpitë e pastra dhe të rehatshme dhe kopshtet e tyre të bukura zakonisht menaxhohen nga këto zonja. Kanalet përshkojnë gjithë fshatin, ndërsa kopshtet e shtëpive janë të mbushura me zarzavate dhe fruta origjinale të zonës. Mysafirët në fshat gjithashtu provojnë shije të veçanta gatimi.

Disa takime të projektit “Drejt një qeverisjeje të përbashkët të trashëgimisë natyrore dhe kulturore ndërkufitare të rajonit të Liqenit të Ohrit” janë zhvilluar në zonën e Tushemishtit. Një seminar i veçantë për promovimin e natyrës, kulturës së rajonit të Liqenit të Ohrit u zhvillua më 10-11 Maj 2016 dhe disa pjesëmarrës

të këtij takimi qendruan në shtëpitë pritëse të banorëve të Tushemishtit. Pas një gjumi të rehatshëm në shtëpitë e pastra dhe të qeta të zonjave të Tushemishtit, për mëngjes miqve iu shërbyen petulla reçel të bëra në shtëpi, gjalpë e djathë. Barrierat e gjuhës nuk krijojnë aspak vështirësi për zonjat mikpritëse të cilat gjithçka e kalonin me buzëqeshje dhe ngrohtë.

Restoranti tradicional “Lokali Zonja nga Qyteti” në qendër të Tushemishtit, gjithashtu në pronësi të një zonje, është shumë i frekuentuar si nga vendasit dhe vizitorët. Aty të serviret lakror i madh, tip byreku tradicional i gatuar me peta dhe barishte apo zarzavate, të shoqëruar me qofte dhe sallatëra. Pijet lokale shoqëruese janë verë dhe raki, me një varietet special të gjelbër të ngjyrosur nga gjethet e mollës që i japin një shije unike. Tre gra, përfshi dhe pronaren, përveshën mëngët për të përgatitur lakrokrin për pjesëmarrësit e seminarit të turizmit. Miqtë u ndjenë si në shtëpi në këtë fshat të vogël, falë ngrohtësisë dhe mikpritjes së grave të Tushemishtit. Dhe ato janë vetëm disa nga Gratë e Tushemishtit.



Pronarja e një prej shtëpive pritëse në Tushemisht

*“Të qëndrosh me familjen, udhëtimi yt kthehet në një eksperiencë të vërtetë. Përveç se pashë vende të bukura, pata fatin të njoh njerëz dhe të shijoj mikpritjen e tyre të ngrohtë. Shumë më mirë se një hotel i ftohtë dhe anonim.”*

Sarah Court, ICCROM

## Dita e Liqenit të Ohrit



Kryebashkiaket e Ohrit dhe Pogradecit

**21** qershori është dita e Liqenit të Ohrit. Ky vendim u morr 16 vite më parë nga Bordi i përbashkët i Menaxhimit të Liqenit të Ohrit. Është një ditë ku gjithë komunitetet që jetojnë në brigjet e Liqenit të Ohrit kujtojnë vlerat unike të tij. Komunitetet lokale duhet t'u mësojnë fëmijëve të tyre të duan dhe mbrojnë këtë thesar natyror. Me këtë rast çdo vit në bazë rotacioni, tre bashkitë rreth Liqenit të Ohrit (Ohri, Pogradeci dhe Struga), organizojnë aktivitete festive. Këtë vit kjo ditë u festua në qyte-

tin e Ohrit ku një numër aktivitete kulturore dhe sportive u organizuan nga bashkia e këtij qyteti. Një ekspozitë me pikturat e fëmijëve të frymëzuara nga Liqeni i Ohrit u hap këtë ditë. Në fund të aktivitetit, në një mënyrë simbolike, kryebashkiaku i Ohrit, Nikola Bakracheski dhe kryebashkiaku i Pogradecit Eduart Kapri nënshkruan një dokument ku shprehën angazhimin e bashkive të tyre për të ruajtur dhe mbrojtur ekosistemin unik botëror të Liqenit të Ohrit. Ata ven-



Ekspozita e pikturave



Aktivite sportive

dosën dokumentin në një shishe e cila u dërgua thellë në liqen nga një varkë. Dita e Liqenit të Ohrit mbledh së bashku tre bashkitë nga qytetet rreth Liqenit duke bërë të mundur bashkimin e forcave për të unifikuar politikat e tyre dhe veprimet drejt garantimit të një mbrojtje të plotë dhe afatgjatë të Liqenit. Dita simbolike e Liqenit gjithashtu angazhon dhe komunitetet, duke i ndihmuar të rrisin ndërgjegjësimin për mbrojtjen e Liqenit të Ohrit.

## Festivali i Filmit mjedisor në Shqipëri



Disa nga filmat e shfaqura ne Festival

Foto djathtas: Fituesit e festivalit "Vjosa River"

Shqipëria organizoi për të katërtin vit rresht Festivalin mjedisor të Filmit. Festivali u zhvillua nga 22 maji deri në 5 qershor 2016 në 8 vende: Shkodër, Tiranë, Vlorë, Skrapar, Përmet, Ersekë, Gjirokastrë dhe Valbonë. Ekologjia, kultura, ekonomia, emigrimi, luftrat dhe çështjet sociale mes shumë të tjerave, përbënë esencën e këtij festivali, që ka si qëllim të ndajë shqetësimet e përbashkëta për të ardhmen e mjedisit. Më shumë se 70 filma nga më shumë se 40 shtete u shfaqën në këtë festival (EFTA). Pesë prej tyre tregonin histori për liqenet në botë dhe rëndësinë e mbrojtjes së ekosistemit dhe botës së gjallë të

tyre, si për shembul filmi "Liqeni i Vetmuar" në Iran, filma për "Liqenin e Shkodrës" në Mal të Zi dhe Shqipëri, Liqenin "Maggiore" në jug të Alpeve mes Italisë dhe Zvicrës, Liqenin "Maracibo" në Venezuelë dhe "Cavazo" në Itali. Qëllimi i festivalit është të shfaqë filmat dhe dokumentarët më të mirë për mjedisin, si ndërkombëtarë dhe shqiptarë, si dhe të përfshijë komunitete të ndryshme shoqërore pavarësisht nga mosha, vendi dhe prejardhja. "Vjosa Story", një film rreth mbrojtjes së lumit më të egër në Europë u përzgjedh si Filmi më i mirë në kategorinë e Filmit Ndërkombëtar me

metrash të gjatë. Filmi jep një mesazh të qartë dhe të fortë se përse duhet të luftohet dhe të mbrohet një nga lumenjtë më të egër të mbetur ende në Europë. Festivali u organizua nga Ministria Shqiptare e Mjedisit dhe Delegacioni i BE në Tiranë, në bashkëpunim me ambasadat dhe partnerët e OJF në vend. Festivali i Filmit mjedisor Shqipëri, mbrojnë idenë se e drejta e mjedisit është një e drejtë për këdo, një e mirë e përbashkët që ka rëndësi të madhe në jetën tonë të përditshme por dhe për planetin ku jetojmë.



# partnerët



**UNESCO**  
Qendra e Trashëgimisë Botërore-koordinatore e Projektit



**Bashkimi European-Kontribuesi Kryesor Financiar**



**Ministria e Mjedisit e Republikës së Shqipërisë**



**Ministria e Kulturës e Republikës së Shqipërisë**



**Ministria e Kulturës e ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë**



**Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Fizik të ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë**



**ICCROM**  
(Qendra Ndërkombëtare për Studimin e Ruajtjes dhe restaurimit të Pasurisë Kulturore)



**ICOMOS**  
(Këshilli Ndërkombëtar mbi Monumentet e Vendet)



**IUCN**  
(Unioni Ndërkombëtar për ruajtjen e Natyrës)

# Kalendar

## Aktivitetet e ardhshme

**12 korrik -20 gusht 2016** Festivali i 56 Veror në Ohër

**31 Korrik-5 Gusht** Festivali Ballkanik i Filmit dhe Ushqimit përfshi programin MISH MASH për prodhuesit e rinj të filmave nga Europa Juglindore

**4-13 October 2016** Kurs në promovimin e rajonit turistik të Ohrit me fokus-njeriun: Angazhimi i komuniteteve për ruajtjen e natyrës dhe kulturës (në Tiranë dhe në rajonin e Liqenit të Ohrit në Shqipëri e Maqedoni)

**Nëntor 2016** Trajnim për ruajtjen dhe menaxhimin e ekosistemit të rajonit të Liqenit të Ohrit

**Dhjetor 2016** Trajnim për zhvillimin e iniciativave të qëndrueshme

## Të Mbrojmë Liqenin e Ohrit

*Kjo është një gazetë e publikuar nga Projekti :Drejt një qeverisjeje të përbashkët të trashëgimisë natyrore dhe kulturore ndërkufitare të rajonit të Liqenit të Ohrit.*

Gjuhët: Anglisht, Shqip, Maqedonisht.

*Në numrin tjetër: Aktivitete të projektit, Turizmi rreth liqenit të Ohrit, Fushata e ndërgjegjësimit për mbetjet, etj...*

Faqja e projektit: <http://whc.unesco.org/en/lake-ohrid-region>

Twitter: [https://twitter.com/lake\\_ohrid](https://twitter.com/lake_ohrid)

Facebook: <https://www.facebook.com/LakeOhridHeritage/>

Blog: <http://lakeohrid.blogspot.al/>

Per komente/suggjerime email: [a.fiebig@unesco.org](mailto:a.fiebig@unesco.org)

Copyright: UNESCO